

# ANALIZA E TRENDIT

## QËNDRIMET E KOMUNITETIT SERB NË KOSOVË



**Porositësi i hulumtimit:**

OJQ Aktiv

**Autorë të hulumtimit:**

Docent dr Stefan Surlić

**Donator:**

National Endowment for Democracy (NED)

**Për botuesin:**

OJQ Aktiv

**Adresa:**

Mbreti Petar 183a, Mitrovicë Veriore  
Qamil Hoxha, kati 1, banesa nr. 2, Prishtinë  
Rr. e Kosovës nr. 17, kati 3, Beograd

**E-mail:**

[info@ngoaktiv.org](mailto:info@ngoaktiv.org)

**Uebsajti:**

[www.ngoaktiv.org](http://www.ngoaktiv.org)

Mitrovicë Veriore, dhjetor 2023.

# PËRMBAJTJA

HYRJE	5
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT DHE PËRSHKRIMI I MOSTRËS	7
REZULTATET E HULUMTIMIT	9
1. QËNDRIMET E PËRGJITHSHME	11
2. BESIMI TEK VENDIMMARRËSIT	19
3. BESIMI NË INSTITUCIONE	25
4. QËNDRIMI NDAJ PJESËMARRJES AKTIVE NË PROCESET POLITIKE	31
5. LIRIA E SHPREHJES DHE QASJA NË INFORMACION	39
6. SIGURIA E QYTETARËVE	45
7. TENDENCAT E MIGRIMIT	51
8. QËNDRIMET NDAJ BASHKIMIT EVROPIAN	57
9. DISTANCA ETNIKE	61



Hulumtimi vjetor i opinionit publik “Analiza e trendit 2023”, i realizuar nga organizata joqeveritare AKTIV, studion hollësisht ndryshimet në qëndrimet dhe pikëpamjet e komunitetit serb në Kosovë lidhur me temat e rëndësishme socio-politike. Qysh nga fillimi i tij në vitin 2016 në katër komuna në veri, e deri në shtrirjen e tij në të gjitha komunat me shumicë serbe në vitin 2019, ky hulumtim është bërë vendimtar për të kuptuar nevojat, prioritetet dhe shqetësimet e komunitetit serb. Rezultatet e këtij viti treguan një shkallë pesimizmi edhe më të madh nga ata të mëparshmit, gjë që vjen si pasojë e frikës në rritje për një konflikt të mundshëm të hapur.

Hulumtimi i vitit 2023 pasqyron një përqendrim të konsiderueshëm në të gjitha segmentet - nga marrëdhëniet ndëretnike deri te perceptimi i situatës së sigurisë. Këtë vit, frika në rritje nga konflikti dhe tensioni i rritur politik kanë rezultuar në pesimizëm të thellë brenda komunitetit serb. Në veçanti, prirje negative janë shënuar në lidhje me pritshmëritë për të ardhmen dhe ndjenjën e përgjithshme të sigurisë.

Ngjarjet që shënuan vitin e kaluar, përfshirë vendimet politike dhe dështimin për të materializuar dialogun ndërmjet qeverisë së Kosovës dhe serbëve, shkaktuan shqetësime serioze në komunitet. Pritet që këto ngjarje të kenë pasoja negative afatgjata në marrëdhëniet ndëretnike dhe bashkëpunimin e përgjithshëm ndërmjet komuniteteve.

Hulumtimi tregoi se përkundër vazhdimit të disa formave të komunikimit dhe bashkëpunimit, ekziston një ndjenjë në rritje e pasigurisë dhe mosbesimit, ndjenjë e cila edhe më tej ndërlikon dinamikën tashmë komplekse politike dhe sociale. Këto gjetje paraqesin një sinjal të qartë urgjent për qasje të reja dhe më gjithëpërfshirëse për zgjidhjen e krizës, me fokus të veçantë në mbrojtjen e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit serb në Kosovë.

Thelbi i rezultateve të këtij viti është frika gjithnjë e pranishme e cila është pasojë e çështjeve ende të pazgjidhura, siç është formimi i Asociacionit të Komunave Serbe (AKS) dhe apatia mbizotëruese kur bëhet fjalë për potencialin e arritjes së një zgjidhjeje afatgjate që do ofronte mbrojtje (si institucionale ashtu edhe të tjera) të nevojshme për të ndaluar largimin nga Kosova. Sido që këto rezultate të interpretohen, politikëbërësit dhe vendimmarrësit duhet t'i shohin si një kujtesë për nevojë urgjente të inicimit të përpjekjeve të reja dhe gjithëpërfshirëse që synojnë përmirësimin e zbatimit institucional të ligjeve që mbrojnë të drejtat e komuniteteve joshumicë dhe pa dyshim ngritjen e nivelit të cilësisë të jetës së tyre.

Në këtë kapitull në pika të shkurtra janë paraqitur trendet më domethënëse për vitin 2023, ndërsa në tekstin në vazhdim janë paraqitur në detaje të gjitha të dhënat e disponueshme. Kur bëhet fjalë për trendet kyçe:

95.5%

e të anketuarve konsiderojnë se situata në Kosovë nuk po shkon në drejtim të duhur

57.1%

e të anketuarve konsiderojnë se në tre vitet e ardhshme jeta e serbëve në Kosovë do të përkeqësohet

69.2%

e të anketuarve konsiderojnë se paqëndrueshmëria politike është problemi kryesor në Kosovë

88.9%

e të anketuarve në veri të Kosovës kanë treguar se ata ose anëtarët e familjeve të tyre janë kërcënuar drejtpërdrejt

83.6%

e të anketuarve thonë se në Kosovë nuk ka parti politike apo politikanë të cilëve u besojnë

1.35

është vlerësimi sipas banorëve të veriut, dhe besimi më i ulët është te Qeveria dhe Policia e Kosovës

56.9%

e të anketuarve konsiderojnë se nga akterët ndërkombëtarë, Rusia është mbrojtësi më i mirë i interesave të komunitetit serb në Kosovë.

18.9%

e të anketuarve konsiderojnë se AKS do të formohet

40.5%

e të anketuarve konsiderojnë se Marrëveshja ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës është më e pranueshme për serbët e Kosovës

14.8%

e të anketuarve e mbështesin idenë e demarkacionit

## METODOLOGJIA E HULUMTIMIT DHE PËRSHKRIMI I MOSTRËS

Hulumtimi është kryer në terren dhe si mjet primar është përdorur metoda e anketimit. Pyetësi i përbërë nga 36 pyetje shërbeu si bazë për mbledhjen e të dhënave përkatëse. Korniza kohore e hulumtimit të realizuar shtrihej nga qershori deri në gusht 2023, duke mbuluar një gamë të gjerë informacioni gjatë asaj periudhe. Mostra prej 536 të anketuar formoi bazën e analizës, duke ofruar njohuri dhe rezultate përkatëse sipas përgjigjeve të mbledhura. Nga ky numër, 270 janë me vendbanim në pjesën veriore të Kosovës, ndërsa 266 të anketuar jetojnë në komunat në jug të lumit Ibër, komuna me prani të konsiderueshme të serbëve të Kosovës.

### Struktura e mostrës sipas vendbanimit të të anketuarve

Veriu i Kosovës

50.4%

Komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër

49.6%



### Struktura e mostrës sipas gjinisë së të anketuarve

Burra



51.9%

Gra



48.1%

### Struktura sipas moshës së të anketuarve

deri në 29

29.7%



nga 30 deri në 45

41.6%



nga 46 deri në 65

22.9%




mbi 65

5.8%




## Struktura e mostrës sipas arsimit të të anketuarve

Fillor .....	3.5%
I mesëm .....	39.2%
Shkollë e lartë .....	22.2%
Fakultet .....	33.8%
Nuk u deklaruan .....	1.3%



## Struktura e mostrës sipas statusit të punësimit të të anketuarve







REZULTATET E HULIMTIMIT  
**QËNDRIMET E PËRGJITHSHME**

1




**1. Për sa i përket gjendjes politike, ekonomike, të sigurisë dhe financiare në Kosovë, të anketuarit e kombësisë serbe vlerësoan secilën nga këto kategori në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është më e ulëta dhe 5 më e larta:**

	Nota mesatare
Gjendja politike	1.51
Gjendja ekonomike	1.85
Gjendja e sigurisë	1.46
Gjendja materiale	2.70

Të dhënat e marra nga hulumtimi i këtij viti tregojnë se kënaqshmëria me gjendjen aktuale politike, ekonomike, të sigurisë dhe materiale në Kosovë është jashtëzakonisht e ulët. Krahasuar me rezultatet e tre viteve të mëparshme, vërehet një rënie e ndjeshme e kënaqshmërisë me gjendjen politike dhe të sigurisë. Gjithashtu, trendi i rënies së fuqisë financiare të qytetarëve të komunitetit serb në Kosovë vazhdon, ndërsa vetëm gjendja materiale është brenda vlerave kornizë të hulumtimeve të mëparshme. E parë në mënyrë kumulative, përshtypja e përgjithshme mbi aspektet e ndryshme themelore të jetës së serbëve në Kosovë është jashtëzakonisht e keqe.

	2023	2022	2021	2020
Gjendja politike	1.51	2.05	2.01	2.06
Gjendja ekonomike	1.85	2.07	2.2	2.08
Gjendja e sigurisë	1.46	2.04	1.93	2.17
Gjendja materiale	2.70	2.60	2.74	2.84


**VENDBANIMI** Veriu i Kosovës Komunitat me shumicë serbe në jug të lumit Iber



## GJENDJA POLITIKE

Veriu i Kosovës

Komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër




Vështruar për nga aspekti i vendbanimit, vërehet se qytetarët në jug të lbrt e vlerësojnë gjendjen politike pak më mirë se të anketuarit nga veriu i Kosovës. Përderisa 69% e të anketuarve nga veriu i Kosovës e vlerësojnë gjendjen politike si shumë të keqe, të anketuarit në jug të lbrt kryesisht pajtohen me këtë perceptim të gjendjes politike, megjithatë frekuenca e këtij perceptimi është pak më shumë se 13% më e ulët në krahasim me të anketuarit nga veriu i Kosovës. Analizuar në mënyrë të segmentuar, rreth 20% e serbëve nga veriu e përkufizojnë gjendjen si të keqe, ndërsa përqindja në jug është për 10% më e lartë. Në krahasim me vitin e kaluar, është vërejtur rritje e papritur e të anketuarve që e përkufizojnë gjendjen si shumë të keqe dhe një rënie të ndjeshme të përqindjes së atyre që i shohin rrethanat politike si të mira, gjë që tregon një ndryshim të konsiderueshëm për serbët që jetojnë në Kosovë.


## GJENDJA EKONOMIKE

Veriu i Kosovës


Komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër



Kur kemi të bëjmë me përshtypjen lidhur me gjendjen ekonomike, vërehet një rënie e dukshme e kënaqëshmërisë me gjendjen ekonomike në mesin e të anketuarve nga veriu i Kosovës. Në të dyja mjediset, gjendja ekonomike është vlerësuar nga shumica si shumë e keqe, por diferenca në përqindje është rreth 18% me perceptim më negativ tek të anketuarit në veri. Kumulativisht, më shumë se dy të tretat e qytetarëve në jug të lumit Ibër dhe në veri e shohin gjendjen ekonomike si të keqe ose shumë të keqe.




Në krahasim me vitin paraprak, për shkak të situatave të shpeshta me ekseze, pritej që vlerësimi për këtë vit lidhur me gjendjen e sigurisë nga të anketuarit në veri dhe jug të lbrit të ishte shumë më negativ. Është gjithashtu interesant fakti se përkundër problemeve më të mëdha në veri, ndryshueshmëria në raport me vendbanimin është ulur, kështu që më shumë se 90% e banorëve në veri dhe më shumë se 80% në jug konsiderojnë se siguria është e keqe ose shumë e keqe. Kumulativisht, komuniteti serb pothuajse njëzëri percepton se jeton në një mjedis të cenuar të sigurisë.




Përshtypja e vetme e të anketuarve që mbeti brenda vlerave kornizë të analizave të mëparshme të trendit është gjendja materiale. Përqindja më e madhe e të anketuarve e vlerëson gjendjen materiale në mënyrë neutrale, as të mirë as të keqe. Krahasuar me vitin e kaluar, mund të vërehet një rënie e numrit të të anketuarve që konsiderojnë se gjendja e tyre materiale është e mirë. Kjo përqindje ishte ndërmjet 16.8% dhe 21% vitin e kaluar, ndërsa këtë vit varion ndërmjet 13.6% dhe 15.8%. Rënia në komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër, përkundër shfaqjes së integritimit të tyre të suksesshëm, tregon për praninë e një problemi serioz socio-ekonomik. Këto të dhëna, së bashku me të dhënat që kanë të bëjnë me perceptimin e gjendjes së përgjithshme ekonomike, qytetarëve të komunitetit serb në Kosovë nuk i japin arsye për optimizëm ekzistencial.

## 2. A janë duke u zhvilluar gjërat në Kosovë në drejtim të duhur?




Që nga viti 2020, vlerësimet politike për gjendjen e përgjithshme në Kosovë janë vlerësuar shumë negativisht, duke filluar nga 85.6% deri në 95.5% të të anketuarve të këtij viti që besojnë se gjërat në Kosovë po zhvillohen në drejtim jo të mirë. Shqetësues është trendi në rritje të vazhdueshme në favor të parashikimeve pesimiste. Gjegjesisht, nga viti 2020 e deri më sot, përqindja e të anketuarve që besojnë se Kosova po ecën në drejtimin e duhur ka rënë nga 14.4% në 4.5%.




Nga gjendja në të cilën në vitin 2020 çdo i shtati i anketuar besonte se Kosova po ecën në drejtim të duhur, ka ardhur deri në pikën që në vitin 2023 vetëm çdo i 15 i anketuar ndan një qëndrim optimist për të ardhmen e Kosovës.


### 3. Sipas mendimit tuaj, jeta për serbët në Kosovë pas tre vjetësh do të jetë?



Në përputhje me të dhënat rreth perceptimit të jetës së përgjithshme në Kosovë, hulumtimi i sivjetshëm tregon se ka pasur një rritje të numrit të të anketuarve që besojnë se jeta për serbët në Kosovë në tre vitet e ardhshme do të jetë edhe më e keqe. Krahasuar me vitin e kaluar, përqindja tashmë e lartë u rrit me një shtesë prej 2%. Nëse këtyre të dhënave i shtohet edhe fakti se vetëm 7.5% e të anketuarve besojnë se në vitet e ardhshme jeta në Kosovë do të jetë më e mirë, fitojmë një pasqyrë më të qartë të perceptimeve të qytetarëve në veri dhe jug të lumit Ibër që dominohen nga mungesa e shpresës, frika dhe pesimizmi.



Kur këtë pyetje e shtjellojmë edhe sipas vendbanimit, mund të vërehet se nuk ka dallime të theksuara ndërmjet banorëve të veriut të Kosovës dhe banorëve në jug të Ibrit. Dallimi mund të shihet nëse bëhet krahasimi i përgjigjeve në këtë pyetje të hulumtimit të sivjetmë me ato të vitit të kaluar. Të dhënat tregojnë se një numër i konsiderueshëm i të anketuarve në jug të Ibrit të cilët vitin e kaluar menduan se gjërat do të përkeqësohen u rrit për gati 7% këtë vit, kurse kjo përqindje në veri është më e lartë për rreth 3%.






## 4. Sipas mendimit tuaj, cili është problemi më i madh në Kosovë?

Është e dukshme rritja e ndjeshme e perceptimit të jostabilitetit politik si problem kryesor në Kosovë në vitin 2023, nga 39.2% në vitin 2022 në 69.2%. Kjo rritje pothuajse e dyfishtë tregon për ngritje të madhe të tensioneve politike dhe ndjenjës së pasigurisë në mesin e qytetarëve të kombësisë serbe. Në vitin 2023, 58,4% e qytetarëve si problem e identifikojnë gjendjen ekonomike dhe papunësinë, që tregon për rënie në krahasim me një vit më parë kur ky problem ishte më i theksuar me 65,4%. Kjo rënie mund të reflektojë rimëkëmbjen nga pasoja të luftës në Ukrainë dhe pandemia Covid19, si dhe një ndryshim në perceptimin e prioritetëve ekonomike lidhur me problemet politike dhe të sigurisë në rritje. Siguria në vitin 2023 është bërë një shqetësim më domethënës, me 64.6% krahasuar me 38.8% në vitin 2022, që paraqet një rritje të konsiderueshme dhe mund të sinjalizojë frikën e justifikuar nga përsëritja e ekseseve, veçanërisht në veri të Kosovës. Çështjet e krimit dhe korrupsionit janë identifikuar si problem edhe nga një numër më i madh i qytetarëve në vitin 2023 (46,6%) në krahasim me vitin 2022 (40.6%), çka tregon shqetësim të vazhdueshëm për këto probleme sociale. Migrimi dhe largimi i të rinjve mbeten një shqetësim i rëndësishëm, megjithëse në vitin 2023 shënoi një rënie në 52.2% nga 55.5% në 2022. Kjo ende tregon për probleme në mbajtjen e qytetarëve të rinj dhe të arsimuar brenda vendit, probleme që mund të kenë pasoja afatgjata në strukturën demografike dhe ekonomike të shoqërisë.

PROBLEMI MË I MADH NË KOSOVË	2023	2022	2021
Paqëndrueshmëria politike	69.2%	39.2%	52.6%
Gjendja ekonomike/papunësia	58.4%	65.4%	25.2%
Siguria	64.6%	38.8%	47.4%
Krimi dhe korrupsioni	46.6%	40.6%	43.7%
Migrimi, largimi i të rinjve	52.2%	53.5%	51.1%

Në përgjithësi, analiza e trendit tregon shqetësim në rritje lidhur me situatën politike dhe të sigurisë në Kosovë, përderisa kriza ekonomike dhe problemet sociale si krimi, korrupsioni dhe migrimi mbeten lartë në listën e sfidave me të cilat përballen qytetarët.

## 5. A ka ndryshuar gjendja ekonomike në Kosovë në vitin e fundit?



Duke analizuar perceptimin për gjenden ekonomike në Kosovë në mesin e komunitetit serb, mund të konstatohet se pesimizmi është shumë i përhapur. Shumica e të anketuarve, më saktë 63.8%, konsiderojnë se gjendja ekonomike në vitin e kaluar është përkeqësuar. Kjo e dhënë tregon qartë pakënaqësinë e rrënjosur thellë në zhvillimet aktuale ekonomike. Një përqindje prej 33.4%, përkatësisht një e treta e të anketuarve, konsiderojnë se nuk ka pasur ndryshime në gjendjen ekonomike, gjë që mund të tregojë se disa kushte ekonomike tashmë janë forcuar, pavarësisht rrethanave politike dhe të sigurisë.

Kumulativisht, rezultatet, kur bëhet fjalë për perspektivat ekonomike, pasqyrojnë shqetësimin e thellë dhe pikëpamjen pesimiste të komunitetit serb në Kosovë. Një përqindje shumë e lartë e atyre që ndiejnë se gjendja është përkeqësuar mund të ketë implikime në paqen sociale, stabilitetin politik dhe potencialin për zhvillim ekonomik.




REZULTATET E HULUMTIMIT

**BESIMI TEK  
VENDIMARRËSIT**




## 6. Sa shpesh ndiqni zhvillimet politike?




Kur bëhet fjalë për informimin, hulumtimi i këtij viti tregon se në krahasim me vitin e kaluar ka pasur dyfishim të shpeshtësisë së ndjekjes së ngjarjeve politike në baza ditore. Gjithashtu, trendi i popullatës që tradicionalisht është shprehur se rrallë ndjek ngjarjet politike ka rënë, dhe për herë të parë kjo përqindje është nën 40% të të anketuarve. Arsyet për këtë mbase lidhen me nevojën e qytetarëve të informohen në kohë për shkak të krizës në rritje në veri të Kosovës, rritjes së aktiviteteve të njëanshme të autoriteteve në Prishtinë, si dhe shpeshtësisë së ekseseve.


Ndjekja e zhvillimeve politike




## 7. A ka politikanë apo parti politike në Kosovë në të cilët keni besim?



Besimi në liderët politikë është një element kyç për mbijetesën dhe prosperitetin e çdo komuniteti politik, dhe kjo është edhe më e rëndësishme në shoqëritë që përballen me pasojat e pazgjidhura të konflikteve të luftës. Komunitete të tilla, duke përfshirë edhe atë serb në Kosovë, kërkojnë nivele dukshëm më të larta të besimit të ndërsjellë si me shqiptarët ashtu edhe me përfaqësuesit e tyre politikë. Përpjekjet kërkimore shumë vjeçare në anketimin e serbëve në Kosovë tregojnë një trend të rënies së besimit në politikanët. Këtë vit, bëhet fjalë për një rekord prej 83.5% e të anketuarve që deklaruan se nuk ka politikan apo parti politike që i besojnë. Që nga viti 2020, trendi i rritjes së mosbesimit megjithatë ka krijuar një diskrepancë të konsiderueshme mes vitit të kaluar dhe këtij viti, pra është regjistruar një kërcim mbi 15%.



Të dhënat nga hulumtimi tregojnë se shkalla e ndjekjes së ngjarjeve politike sipas vendbanimit të politikanëve është mjaft uniforme, ndonëse vërehet se këtë vit banorët e veriut të Kosovës në përqindje të caktuara i ndjekim më shpesh ngjarjet politike (3,3% ose 6.6%).



## 8. Cilit politikan/parti politike serbe në Kosovë i besoni?

Analiza e të dhënave të mbledhura tregon një nivel shumë të ulët të besimit të të anketuarve në politikanët dhe partitë politike serbe në Kosovë. Pavarësisht perceptimit se ka mbështetje pothuajse unanime për Aleksandar Vuçiqin dhe Partinë Progresive Serbe, ata gëzojnë besimin e 2.6% të të anketuarve, gjë që i vendos në vendin e parë në krahasim me opsionet e tjera të listuara. Listës Serbe i besojnë 1.8% e të anketuarve, që është pak më pak se SNS. Edhe figurat e reja politike si Aleksandar Arsenijević, për të cilin kanë votuar vetëm 0.4% e të anketuarve, nuk gëzojnë besim, mirëpo kjo ka të bëjë me mohimin e çdo organizate politike jashtë Listës së shpallur Serbe.

CILIT POLITIKAN APO PARTI POLITIKE SERBE I BESONI?	% e të anketuarve
Aleksandar Vuçiq – SNS	2.6%
Lista serbe (Srpska lista)	1.8%
Aleksandar Arsenijević	0.4%
Partia Socialiste e Serbisë	0.2%

## 9. Cilët politikan/parti politike shqiptare në Kosovë i besoni?

CILËT POLITIKAN APO PARTI POLITIKE SHQIPTARE I BESONI?	% e të anketuarve
Albin Kurti	0.2%
LDK - Partia e Rugovës	0.2%
Veton Surroi	0.2%

Të dhënat tregojnë se besimi tek politikanët dhe partitë politike shqiptare në mesin e komunitetit serb në Kosovë është jashtëzakonisht i ulët. Secili prej emrave dhe partive të përmendura - Albin Kurti, LDK – partia e Rugovës, dhe Veton Surroi - gëzon besimin e vetëm 0.2% të të anketuarve. Ky nivel po aq i ulët i besimit ndaj figurave të ndryshme politike shqiptare tregon një mosbesim të fuqishëm në opsionet politike të komunitetit shumicë dhe, në të njëjtën kohë, pamundësinë e ndonjë integrimi serioz të komunitetit serb në shoqërinë kosovare.





REZULTATET E HULLIMITIMIT  
**BESIMI NË INSTITUCIONE**

3



## 10. Në një shkallë prej 1 deri në 5, vlerësoni sa jeni të kënaqur me punën/performancën e institucioneve të mëposhtme?

Edhe këtë vit dy institucionet e vlerësuara më së miri nga qytetarët me kombësi serbe janë Qeveria e Republikës së Serbisë dhe Zyra për Kosovë e Metohi. Organet e përkohshme të vetëqeverisjes lokale pothuajse janë barazuar me KFOR-in, dhe arsyeja e rënies së mbështetjes mund të gjendet në mospjesëmarrjen e serbëve në institucionet lokale. Edhe pse të tria institucionet vazhdojnë të kenë rënie në mbështetje, ato janë ende shumë më të vlerësuara se çdo institucion kosovar, përfshirë edhe Policinë me notë 1.79.

NË NJË SHKALLË NGA 1 DERI NË 5, SA JENI TË KËNAQUR ME PERFORMANCËN E INSTITUCIONEVE TË MËPOSHTME	2023	2022	2021	2020
Organet e përkohshme të vetëqeverisjes lokale	2.17	2.55	2.59	2.56
Komunat me sistem kosovar	2.15	2.5	2.6	2.45
Zyra për Kosovë dhe Metohi	2.46	2.74	2.82	2.54
Qeveria e Serbisë	2.53	3.07	3.22	2.89
Qeveria e Kosovës	1.61	1.77	1.73	1.95
Deputetët serb në Kuvendin e Kosovës	1.8	2.14	2.21	2.12
Ministrat serb në Kuvendin e Kosovës	1.74	2.08	2.25	2.12
UNMIK	2.09	2.08	1.95	2.19
Zyra e BE-së në Kosovë	1.95	1.99	1.95	2.09
EULEX	1.99	1.96	1.79	1.96
KFOR	2.18	2.31	2.09	2.23

SI JENI TË KËNAQUR ME PERFORMANCEN E POLICISË SË KOSOVËS

2023

Policia e Kosovës

1.79

Analiza e të dhënave të mbledhura tregon një tendencë të përgjithshme të besimit më të madh në institucionet nga të anketuarit nga komunat me shumicë serbe në jug të lbrit në krahasim me ata nga pjesa veriore e Kosovës. Vërehet se të gjitha institucionet, duke filluar nga ato të vetëqeverisjeve lokale në sistemin serb apo kosovar, përmes përfaqësuesve të qeverive të Serbisë dhe Kosovës e deri te organizmat ndërkombëtar, kanë një shkallë mesatare më të lartë të besimit tek të anketuarit në jug të lumit Ibër. Kjo mund të nxjerr në pah dallime në perceptim dhe përvojë në mes dy grupeve të komunitetit serb, pasi që të anketuarit në jug të lbrit në periudhën e kaluar, përveç institucioneve serbe, ishin të orientuar kah ndërveprimi më i madh me sistemin kosovar si dhe me institucionet e ndryshme ndërkombëtare.



	Veriu i Kosovës	Komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër
Organet e përkohshme të vetëqeverisjes lokale	1.84	2.50
Komunat (serbe) me sistem kosovar	1.74	2.56
Zyra për Kosovë dhe Metohi	2.16	2.76
Qeveria e Serbisë	2.12	2.95
Qeveria e Kosovës	1.35	1.87
Deputetët serb në Kuvendin e Kosovës	1.61	1.99
Ministrat serb në Qeverinë e Kosovës	1.57	1.91
Policia e Kosovës	1.36	2.23
UNMIK	1.74	2.44
Zyra e BE-së në Kosovë	1.59	2.32
EULEX	1.59	2.38
KFOR	1.68	2.69

## II. Sipas jush, cili nga faktorët kryesorë ndërkombëtarë është mbrojtësi më i mirë i interesave të serbëve të Kosovës?


Edhe pse i shënuar me ngjarje të trazuara, viti 2023, kur bëhet fjalë për akterët ndërkombëtarë nuk solli ndryshime të rëndësishme në qëndrimet e qytetarëve të komunitetit serb në Kosovë. Përkundër vazhdimit të agresionit rus ndaj Ukrainës dhe izolimit të vazhdueshëm të Rusisë në nivel ndërkombëtar, në sytë e të anketuarve të kombësisë serbe në Kosovë, Rusia mbeti e perceptuar si mbrojtësja më e mirë e interesave të serbëve të Kosovës me 56,9%, edhe pse kjo paraqet një rënie krahasuar me 64,3% të vitit të kaluar. Kjo rënie mund të jetë tregues i një perceptimi pjesërisht të ndryshuar të rolit të saj dhe ndikimit të kufizuar në Ballkan.

Pason Bashkimi Evropian si akter ndërkombëtar, për të cilin 15,7% e të anketuarve besojnë se mbron më së miri interesat e serbëve në Kosovë, me një rritje të konsiderueshme prej gati 6% për një vit.

Kina shënon një rënie të lehtë në mbështetje, nga 13% në 2022 në 11,8% në 2023, duke sugjeruar se ndikimi i saj mbetet relativisht i qëndrueshëm, por i kufizuar në komunitetin serb në Kosovë. Përqindja më e ulët në favor të Shteteve të Bashkuara të Amerikës është pothuajse konstante, me vetëm 2,8% në vitin 2023, gjë që tregon se SHBA-ja nga shumica perceptohet ende si fuqi globale që punon në dëm të interesave të serbëve që jetojnë në Kosovë.



## 12. A posedoni ndonjë dokument personal të lëshuar nga institucionet e Kosovës (letërnjoftim, pasaportë, patentë shofer, certifikatë të lindjes dhe shtetësisë (ekstrakt)...?



Bazuar në trendet nga gjashtë ciklet e fundit të hulumtimit, bëhet e qartë se që nga viti 2017, përqindja e të anketuarve të nacionalitetit serb që posedojnë çfarëdo dokumenti personal të lëshuar nga institucionet e Kosovës është rritur ndjeshëm. Të dhënat tregojnë për një përqindje më të lartë të pjesëtarëve të komunitetit serb në komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër që posedojnë dokumente të Kosovës, me 91.4% të cilët janë përgjigjur me po, ndërsa në pjesën veriore të Kosovës ajo përqindje është 81.8%. Përkundër pretendimeve në veri të Kosovës për rezistencë më të shprehur ndaj dokumenteve kosovare, është e qartë se shumica dërrmuese kanë marrë letërnjoftime të Kosovës. Mbetet një pyetje e hapur nëse 18% e popullatës në veri nuk janë në gjendje të marrin dokumente personale për shkak të pengesave sistematike apo nëse bëhet fjalë për zgjedhje të lirë.

A POSEDONI DOKUMENTE KOSOVARE?	Veriu i Kosovës	Komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër
Po	81.8%	91.4%
Jo	18.2%	7.5%
Nuk u deklaruan	0%	1%




REZULTATET E HULIMTIMIT

**QËNDRIMI NDAJ  
PJESËMARRJES AKTIVE NË  
PROCESET POLITIKE**





### 13. Cili është qëndrimi juaj rreth vazhdimit të dialogut/bisedimeve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës nën patronazhin e BE-së (dialogu i Brukselit)?



Mbështetja për Dialogun e Brukselit është më e theksuar në komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër, dy herë më e lartë në përqindje krahasuar me banorët në veri të Kosovës (24.1% kundrejt 12.2%). Kur kësaj i shtohet se pothuajse gjysma e të anketuarve nga veriu i Kosovës, 49.6%, nuk e mbështesin Dialogun e Brukselit, me të drejtë mund të vihet në pah frika e serbëve në veri se vazhdimi i dialogut nuk do të sjellë rezultatet e pritura, pra se disa marrëveshje mund të perceptohen edhe si të dëmshme për komunitetin serb.

QËNDRIMI RRETH DIALOGUT TË BRUKSELIT	Veriu i Kosovës	Komunat me shumicë serbe në jug të lumit Ibër
E mbështes	12.2%	24.1%
Nuk e mbështes	49.6%	35.3%
Nuk kam qëndrim	37.4%	39.8%
Nuk u deklaruan	0.8%	0.8%

Nga një këndvështrim krahasues, janë vërejtur dallime lidhur me opinionin për Dialogun e Brukselit. Në vitin 2023, mbështetja për vazhdimin e bisedimeve shënoi një rritje të lehtë në 18.2% krahasuar me 17.5% në 2022, por është ende më e ulët në krahasim me vitin 2021 dhe 2020. Kjo rritje e lehtë mund të nxjerr në pah bindjen se kriza aktuale në terren mund të zgjidhet vetëm në mënyrë paqësore dhe përmes dialogut të ndërmjetësuar nga BE.

Kundërshtimi për vazhdimin e bisedimeve në Bruksel u rrit në 42,8% në vitin 2023, që është një rritje e lehtë krahasuar me 40,5% në 2022 dhe dukshëm më e lartë se në vitet e mëparshme. Kjo tregon për pakënaqësinë apo pesimizmin në rritje të vazhdueshme lidhur me efikasitetin e dialogut në kontekstin e një ndryshimi të mundshëm të situatës në terren.

QËNDRIMI RRETH VAZHDIMIT TË BISEDIMEVE NË BRUKSEL	2023	2022	2021	2020
E mbështes	18.2%	17.5%	22.4%	20.6%
Nuk e mbështes	42.8%	40.5%	25.9%	28.7%
Nuk kam qëndrim	39%	42%	51.7%	50.7%

Nga ana tjetër, në rënie është numri i atyre që nuk kanë ndonjë qëndrim rreth bisedimeve, gjë e cila me kohë reflektohet nga informimi më i mirë i publikut apo profilizimi i opinionëve rreth bisedimeve. Në mënyrë kumulative, të dhënat tregojnë se ekziston një tendencë për rritjen e qëndrimit negativ ndaj bisedimeve në Bruksel, dhe në të njëjtën kohë rënie e pavendosmërisë tek të anketuarit.

#### 14. Sipas jush, si do të ndikojë në komunitetin serb në Kosovë vazhdimi i bisedimeve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës?

SI DO TË NDIKOJË NË KOMUNITETIN SERB NË KOSOVË DIALOGU NDËRMJET BEOGRADIT DHE PRISHTINËS?	2023	2022	2021
Do të përmirësojë cilësinë e jetës së komunitetit serb	14.1%	15%	18.9%
Do të përkeqësojë cilësinë e jetës së komunitetit serb	35.9%	38.1%	23.7%
Çdo gjë do të mbetet e njëjtë	50%	46.9%	57.4%

Rënia e mbështetjes për vazhdimin e bisedimeve është e lidhur ngushtë me perceptimin e efekteve që mund të ketë dialogu në cilësinë e jetës së serbëve të Kosovës. Duke analizuar perceptimet e të anketuarve, mund të shohim se në vitin e fundit ka pasur një rritje të numrit të të anketuarve të cilët besojnë se vazhdimi i bisedimeve nuk do të sjellë ndonjë ndryshim. Në anën tjetër, është shënuar një rënie e lehtë (35.9%) në përqindjen e atyre që mendojnë se bisedimet do të kenë ndikim shtesë në rënie, përkatësisht në përmirësimin e cilësisë së jetës së pjesëtarëve të komunitetit serb në Kosovë (14.1%).

## 15. A do të formohet Asociacioni i Komunave Serbe?

Rezultatet e fituara janë paraqitur duke i krahasuar me rezultatet e viteve të mëparshme:


A do të formohet AKS?	2023	2022	2021	2020
Do të formohet	19%	14%	14.1%	10.5%
Po, por jo këtë vit	33.5%	27.3%	38.5%	31.5%
Nuk do formohet	47.5%	58.7%	47.4%	58%

Të dhënat tregojnë se pothuajse çdo i anketuar beson se së shpejti do të formohet Asociacioni i Komunave Serbe (AKS), që paraqet një rritje në krahasim me 14% në vitin 2022 dhe dukshëm më shumë krahasuar me 10.5% në vitin 2020. Edhe pse më shumë se gjysma e të anketuarve besojnë se AKS do të formohet por pa një afat kohor të qartë, 47.5% konsiderojnë se AKS nuk do të formohet, që është një qëndrim më pak pesimist se vitin e kaluar kur kjo përqindje ishte 58.7%. Rritja e numrit të të anketuarve që besojnë se AKS do të formohet, por jo këtë vit (33,5%), sugjeron gjithashtu për një optimizëm në rritje, mirëpo optimizëm të vëmendshëm në kuptim të realizimit të kësaj kornize institucionale.

## 16. A e mbështetni idenë e demarkacionit?

A E MBËSHTETNI IDENË E DEMARKACIONIT?	2023	2022	2021	2020
Në tërësi e mbështes	14.8%	4.2%	4.3%	4.8%
Nuk kam informacion të mjaftueshëm, por jam i/e hapur për idenë	16.7%	12.1%	20.6%	12.2%
Nuk kam informacion të mjaftueshëm, por nuk e mbështes demarkacionin	17.8%	32.7%	21.1%	24.3%
Nuk e mbështes fare	50.7%	51%	54.1%	58.7%


Viteve të fundit janë ndërmarrë iniciativa të ndryshme për zgjidhjen e statusit të Kosovës, duke përfshirë edhe propozimin për demarkacionin. Megjithatë, ideja e demarkacionit nuk arriti të rrisë ndjeshëm mbështetjen e qytetarëve. Përkundrazi, në vitin 2023 vetëm një përqindje e vogël e të anketuarve prej 14,8%, e mbështetën plotësisht këtë ide, që është një rritje e ndjeshme krahasuar me një vit më parë (4,2%). Numri i atyre që nuk e mbështesin këtë propozim është dukshëm më i lartë, ku 50.7% e të anketuarve haptazi e kundërshtojnë, e që prej vitesh është një përqindje stabile e popullsisë që e kundërshton. Këto të dhëna tregojnë se ndërkohë që ka rritje të mundësisë për diskutim, shumica dërrmuese ende ose nuk e mbështesin idenë e demarkacionit ose ndihen të painformuar për një qëndrim të qartë.




Dallimet që dalin nga vendndodhja unike gjeografike dhe dinamika sociale e zonave të banuara me serbë të Kosovës shpesh çojnë në besime dhe qëndrime të ndryshme për çështje kyçe, siç është edhe ideja e demarkacionit. Serbët që jetojnë në veri të Kosovës tregojnë një preferencë më të madhe për idenë e demarkacionit, me 18.5% të të anketuarve që e mbështesin plotësisht atë, ndërsa serbët në jug të Ibër janë më pak të prirur për ta mbështetur atë, me 10.9% që e mbështesin plotësisht. Megjithatë, përqindja e atyre që nuk e mbështesin fare këtë ide është mjaft e barabartë si në veri ashtu edhe jug të Ibër.

## 17. Si do të ndikonte demarkacioni i mundshëm në vendimin tuaj për të qëndruar në Kosovë?


Me analizën e të dhënave është e dukshme se si me kalimin e kohës qëndrimet e serbëve në Kosovë lidhur me ndikimin e demarkacionit të mundshëm në vendimin e tyre për të qëndruar në Kosovë ndryshojnë. Në vitin 2023, 42,8% e të anketuarve konsiderojnë se demarkacioni do të ndikonte negativisht në vendimin e tyre për të qëndruar, që paraqet një rritje të konsiderueshme krahasuar me 29,4% në 2022.



Megjithatë, me stratifikimin e mostrës sipas vendbanimit, mund të shihet se ka një mospërputhje të konsiderueshme në qëndrimet në mes të veriut të Kosovës dhe komunave në jug të lumit Ibër. Siç pritej, frika e popullatës në Kosovën qendrore shprehej përmes frikës se ata do të bartnin barrën më të madhe të demarkacionit të mundshëm, kështu që 58.3% e të anketuarve deklaruan se do të largoheshin nga vendbanimi i tyre në krahasim me 27% të të anketuarve në veri.



## 18. Pos që Kosova të mbetet në sistemin kushtetues dhe juridik të Serbisë, cili nga skenarët e ofruar për një marrëveshje të mundshme gjithëpërfshirëse ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës do të ishte më i pranueshëm për serbët e Kosovës?



Opsionet e ofruara për të anketuarit në lidhje me statusin e ardhshëm të Kosovës në mesin e qytetarëve të kombësisë serbe nuk marrin mbështetje të gjerë. Njohja e pavarësisë dhe shkëmbimi i territoreve janë opsione që marrin mbështetje minimale. Opsionet më të përkrahura janë formimi i Asociacionit të Komunave Serbe ose ruajtja e statusit aktual. Është interesante të vërehen dy ndryshime kyçe në krahasim me vitin paraprak - dyfishimi i numrit të atyre që mbështesin formimin e Asociacionit të Komunave Serbe nga 20,4% në 40,5% dhe rënia e atyre që besojnë se ruajtja e status quo-së është një zgjidhje e pranueshme afatgjate nga 25,9% në 13,4%. Këto të dhëna implikojnë bindjen e të anketuarve se në rrethanat aktuale nuk është e mundur të ruhet status quo-ja dhe se AKS përfaqëson kornizën institucionale që mund të ofrojë perspektivë më të mirë për komunitetin serb në Kosovë.

MARRËVESHJA MË E PRANUESHME MES BEOGRADIT DHE PRISHTINËS PËR SERBËT E KOSOVËS	2023	2022	2021	2020
Formimi i AKS	40.5%	20.4%	31.3%	29.0%
Shkëmbimi i territoreve (veriu për Luginën e Preshevës)	4.3%	4.6%	2.4%	2.4%
Njohja e Kosovës nga Beogradi	0.9%	1.3%	0.6%	2.6%
Ruajtja e gjendjes ekzistuese (status quo)	13.4%	25.9%	21.3%	27.6%
Asnjë nga përgjigjet e ofruara	29.3%	47.8%	44.4%	38.5%
Tjetër	11.6%	•	•	•




REZULTATET E HULIMTIMIT  
**LIRIA E SHPREHJES DHE  
QASJA NË INFORMACION**







## 19. Mbi çfarë baze ndërtoni pikëpamjet e juaja për politikën dhe ngjarjet politike




Ky vit shënon një rritje të të anketuarve që i ndërtojnë gjithnjë e më shumë pikëpamjet e tyre politike në bazë të informacionit që marrin nga media, ndërsa numri i atyre që krijojnë pikëpamjet e tyre bazuar në opinionet dhe pikëpamjet e familjarëve, miqve dhe kolegëve është përgjysmuar. Roli i politikanëve dhe prijësve fetarë është paksa në rritje, mirëpo është ende i vogël dhe i papërfillshëm. Përqindja më e madhe e të anketuarve që deklaruan se “vet krijojnë opinionin e tyre”, dëshmon për një shkallë të lartë mosbesimi ndaj çdo burimi të opinionit dhe informacionit.

MBI ÇFARË BAZE NDËRTONI QËNDRIM RRETH POLITIKËS DHE NGJARJEVE POLITIKE?	2023	2022	2021	2020
Informacioni nga media	26.6%	19.3%	20.6%	22.7%
Opinionet dhe qëndrimet e familjes, miqve dhe kolegëve	4.6%	8.7%	12.4%	16.4%
Opinionet dhe qëndrimet e politikanëve	4.9%	2.8%	2.0%	3.5%
Opinionet dhe qëndrimet e prijësve fetar dhe institucioneve	2.5%	1.7%	2.0%	0.7%
Të gjitha më lartë	29.6%	29.7%	29.1%	32.2%
Vet e krijoj mendimin tim	31.9%	37.8%	33.9%	24.5%

## 20. Nga cilat media informoheni më shpesh?

Me gjithë trendin e digjitalizimit të informimit rreth politikës dhe ngjarjeve politike, ende rolin më të madh në informim luajnë mediat tradicionale (TV, radio), duke shënuar rritje në krahasim me një vit më parë. Portalet kanë mbështetje të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, ndërsa rrjetet sociale shënojnë një rënie prej më shumë se 5%. Arsyeja për këtë mund të gjendet në plasimin e përmbajtjeve të pa verifikuara dhe tendencioze, veçanërisht në situata krizë që gjatë vitit 2023 kanë qenë të bollshme në veri të Kosovës.




## 21. Në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është “nuk besoj fare” dhe 5 është “besoj plotësisht”, sa besoni në:


NË NJË SHKALLË NGA 1 DERI NË 5, SA JU BESONI MEDIAVE TË MËPOSHTME	2023	2022	2021	2020
Media me një frekuencë kombëtare nga Beogradi	2.69	3.35	3.29	2.85
Media të pavarura nga Beogradi	2.88	2.97	3.12	2.69
Media serbe në Kosovë	2.94	2.92	2.82	2.79
Media në gjuhën shqipe në Kosovë	1.72	1.6	1.57	1.61

Besimi në media në Serbi tregon për ndryshime gjatë katër viteve të fundit. Qytetarët shprehin nivelin më të ulët të besimit në media në gjuhën shqipe në Kosovë, dhe nivelin më të lartë të besimit në mediat serbe në Kosovë. Mediat e pavarura dhe mediat me frekuencë kombëtare nga Beogradi shënuan rënie të besimit. Krahasuar me vitin 2022, vërehet një rënie e dukshme e notës së besimit në mediat me frekuencë kombëtare nga Beogradi, të cilat media në analizën e trendit për vite me radhë zinin vendin e parë. Ky ndryshim mund të nxjerr në pah zhgënjimin e komunitetit serb në Kosovë me raportimin e mediave nga Beogradi për ngjarjet që shënuan vitin 2023.


## 22. A ndiheni të lirë të shprehni publikisht qëndrimet tuaja politike?



Konteksti i përgjithshëm socio-politik që ka sunduar në Kosovë me vite të tëra, sigurisht se nuk është një terren pjellor për nxitjen e autonomisë së opinionit publik dhe lirisë së shprehjes së tij. Megjithatë, krahasuar me vitin e kaluar, ka pasur një rritje të ndjeshme të besimit të të anketuarve se ata ndjehen të lirë të shprehin publikisht pikëpamjet e tyre politike, nga 25.5% në 37%. Krahasuar me vitin 2022, numri i atyre që pretendojnë se nuk ndihen të lirë të shprehin publikisht pikëpamjet e tyre politike është ulur për më shumë se 10%.



### 23. A janë të përfaqësuara mjaftueshëm pikëpamjet e pavarura dhe mendimi kritik në mediat në Kosovë?



Shumica absolute e të anketuarve konsiderojnë se pikëpamjet e pavarura dhe mendimi kritik nuk janë të përfaqësuara sa duhet në mediat në gjuhën serbe në Kosovë. Megjithatë, krahasuar me vitin e kaluar, në pyetje është një rënie e lehtë kur bëhet fjalë për perceptimin e tillë lidhur me lirinë e medias dhe përmbajtjen mediatike. Në anën tjetër, ka një rënie të ndjeshme të numrit të të anketuarve që pohojnë se pikëpamjet e pavarura dhe mendimi kritik janë të përfaqësuara mjaftueshëm në mediat në gjuhën serbe në Kosovë. Bazuar në rritjen e përqindjes së atyre që deklarojnë se nuk i ndjekin mediat në Kosovë, mund të konstatohet se mbizotëron apatia dhe nuk besohet në mundësinë e zhvillimit të opinionit kritik nga ana e medias.




REZULTATET E HULLUMTIMIT  
**SIGURIA E QYTETARËVE**

6



## 24. A është cenuar siguria juaj apo siguria e familjes suaj të ngushtë gjatë vitit të kaluar?





Perceptimi për situatën e sigurisë në Kosovë nga qytetarët e komunitetit serb ka ndryshuar dukshëm në krahasim me tre vitet e mëparshme. Rreth 61.4% besojnë se kanë qenë të cenuar krahasuar me 16-18% gjatë viteve të mëparshme. Kur bëhet stratifikimi sipas vendbanimit, kjo përqindje rritet ndjeshëm, kështu që në veri të Kosovës, pothuajse 89% e të anketuarve kanë pasur përvojë të cenimit të sigurisë së tyre personale apo të familjarëve të tyre. Kjo e dhënë është alarmante dhe tregon arsyetimin e frikës nga destabiliteti politik dhe dhuna në të ardhmen e afërt.

A ËSHTË CENUAR SIGURIA JUAJ APO SIGURIA E FAMILJES SUAJ GJATË VITIT TË KALUAR?


Po

Jo

Nuk u deklaruan




Po Jo







## 25. A ka ndryshuar gjendja e sigurisë në Kosovë në vitin e fundit?



Shumica e serbëve në Kosovë shprehin shqetësimin për sigurinë e tyre, gjë që reflektohet me një përqindje të madhe të atyre që konsiderojnë se gjendja e sigurisë është përkeqësuar (77.3%). Kjo ndjenjë përkeqësimi mund të jetë shkaktuar ose përforcuar nga incidente apo dhuna aktuale, por edhe nga ndjenja e përgjithshme e paqartësisë ose ndryshimeve politike në nivel lokal. Dallimi është veçanërisht i dukshëm krahasuar me vitin e kaluar, i cili u karakterizua edhe nga paqëndrueshmëria, ku 39.9% deklaruan se ishin të shqetësuar për sigurinë e tyre. Grupi që nuk sheh ndryshim (21.2%) mund të jetë ai që është përshtatur me rrethanat ekzistuese ose beson se lëvizja në drejtimin aktual është e pashmangshme.




Ky perceptim i situatës së sigurisë ndoshta ndikon në qëndrimet ndaj largimit të serbëve nga Kosova. Të rinjtë, të cilët natyrisht janë më të prirur për të migruar në kërkim të mundësive më të mira, mund të jenë veçanërisht të ndjeshëm ndaj këtyre perceptimeve.

Po, është përmirësuar


Po, është përkeqësuar

Asgjë nuk ka ndryshuar



## 26. Sipas mendimit tuaj, cilat janë rreziqet më të mëdha të sigurisë në rrethin tuaj?

Paqëndrueshmëria politike, nga numri më i madh i të anketuarve, pra 45.7%, konsiderohet si rrezik parësor. Kjo tregon se tensionet politike dhe pasiguria janë faktorët dominues që ndikojnë në ndjenjën e sigurisë së serbëve në Kosovë.



Incidentet ndëretnike u identifikuan si rreziku i dytë më i rëndësishëm, ku 39% e të anketuarve i shohin ato si një problem madhor sigurie. Kjo reflekton shqetësimet rreth tensioneve dhe konflikteve etnike, të cilat mund të lidhen me kontekstin e konflikteve në të kaluarën e afërt dhe ngjarjet aktuale që potencialisht kanë çuar në konflikte të fundit apo incidente ndëretnike.

Në mënyrë kumulative, këto të dhëna theksojnë faktorët politikë dhe etnikë si burimet kryesore të shqetësimit për serbët në Kosovë, duke potencuar se dinamikat sociopolitike dhe marrëdhëniet ndëretnike janë kyçe në formësimin e ndjenjës së tyre të sigurisë. Situata e sigurisë, siç perceptohet nga të anketuarit, mund të ketë një ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e tyre, vendimet për migrimin dhe ndjenjën e përgjithshme të mirëqenies në komunitet.





REZULTATE E HULUMTIMIT  
**TENDENCA E MIGRIMIT**

7




## 27. Gjatë vitit të fundit a është larguar ndokush nga Kosova nga rrethi juaj i ngushtë?

Mjedisi përgjithësisht jostimules i shoqërisë kosovare, i dominuar nga jostabiliteti politik, problemet ekonomike, mungesa e mbështetjes institucionale dhe mungesa e sigurisë, nxit qytetarët e nacionalitetit serb që të largohen nga Kosova. Sondazhi i këtij viti tregon se mbi 80% e të anketuarve në rrethin e tyre kanë një person që në vitin e fundit është larguar nga Kosova. Në aspektin afatgjatë, një nga problemet kryesore sociale dhe politike të komunitetit serb në Kosovë është shpërpullimi, kryesisht përmes largimit të të rinjve.




Numri i personave që theksojnë se dikush nga komuniteti i tyre është larguar nga Kosova është paksa i ndryshëm në komunat në jug të Ibrit dhe në veri të Kosovës. Krahasuar me vitin e kaluar, ka një rritje të ndjeshme prej madje 13% të përvijës së largimit të dikujt nga rrethi i ngushtë në veri të Kosovës, që kontekstualisht është pasojë e drejtpërdrejtë e ekseseve që shënuan vitin 2023.




## 28. A e shihni veten në Kosovë në pesë vitet e ardhshme?

Këtë vit është shënuar një rritje e atyre që nuk e shohin veten në Kosovë në pesë vitet e ardhshme, ndërsa një përqindje stabile e të anketuarve janë duke pritur mundësinë për t'u larguar nga Kosova. Kjo e dhënë tregon për gjendjen alarmante të keqe prej vitesh në të cilën jetojnë serbët në Kosovë dhe largimi nga Kosova për shumë prej tyre perceptohet si zgjidhja e vetme. Vëzhguar në mënyrë të segmentuar, të dhënat tregojnë se nuk ka dallim të madh ndërmjet të anketuarve nga veriu i Kosovës dhe atyre në jug të lumit Ibër.



Gjithashtu alarmues dhe shqetësues edhe fakti se numri më i vogël i të anketuarve që planifikojnë të qëndrojnë në Kosovë i takon brezit shoqërorë dhe ekonomikisht më të fuqishëm të qytetarëve të moshës 18 deri në 29 vjeç. Vetëm çdo i katërti i anketuar i këtij brezi planifikon të qëndrojë në Kosovë. Tek brezi i parë pasues, ai i moshës 30 deri në 45 vjeç, çdo i dyti i anketuar e sheh veten në Kosovë në pesë vitet e ardhshme. Si rrjedhojë, shumica e atyre që duhet të ndërtojnë një të ardhme më të mirë nuk e shohin veten në Kosovë.





A E SHIHNI VETEN NË KOSOVË NË PESË VITET E ARDHSHME?

Po


Jo

Do të largohem nëse më ofrohet mundësia

Pa përgjigje



## 29. Cila është arsyeja kryesore e largimit tuaj nga Kosova?



Me përmbledhjen e ngjarjeve në veri të Kosovës gjatë vitit 2023, nuk është për t'u habitur që arsyeja kryesore e largimit nga Kosova është mosrespektimi i të drejtave të serbëve në Kosovë. Pothuajse një e treta e të anketuarve është e motivuar nga kjo arsye për t'u larguar nga Kosova. Arsyeja tjetër e barabartë në përqindje është paqëndrueshmëria politike dhe pasiguria ekonomike. Përqindja e lartë prej 21% bart arsyen e sigurisë personale, kështu që më shumë se 75% e pjesëtarëve të komunitetit serb po mendojnë të largohen nga Kosova për shkak të diskriminimit sistematik, frikës nga pasiguria dhe paqëndrueshmëria politike.






REZULTATET E HULLUMTIMIT  
**QËNDRIMET NDAJ  
BASHKIMIT EVROPIAN**




### 30. A ju asocion së pari në diçka pozitive apo negative kur dëgjoni “Bashkimi Evropian”?



Krahasuar me vitin e kaluar, tek të anketuarit e nacionalitetit serb në Kosovë vërehet një trend i dukshëm i rritjes së lehtë të perceptimit pozitiv dhe i rënies së lehtë të perceptimit negativ për Bashkimin Evropian. Aktualisht, vetëm çdo i dhjeti i anketuar ka perceptim pozitiv për Bashkimin Evropian. Arsyeja e këtij qëndrimi vjen pikërisht nga perceptimi se Bashkimi Evropian në procesin e bisedimeve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës nuk është neutral, por se favorizon palën shqiptare dhe punon për njohjen ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. Të dhënat nga disa sondazhe të fundit tregojnë, dhe sondazhi i këtij viti konfirmon, se një përqindje e madhe e të anketuarve besojnë se Bashkimi Evropian e mbështet në bisedime më shumë Prishtinën se Beogradin, gjithsesi nuk është e papërfillshme që një e treta e të anketuarve kanë një qëndrim neutral ndaj BE-së.

### 31. Si e shihni pozicionin e Bashkimit Evropian në procesin e bisedimeve midis Beogradit dhe Prishtinës?



Nga paraqitja grafike e perceptimit të pozitës së Bashkimit Evropian në bisedimet ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, mund të konstatohet se ka një vazhdimësi të përqindjes së lartë të të anketuarve (pothuajse 80%) se BE-ja është në anën e Prishtinës. Ka një trend të dukshëm në rënie të numrit të atyre që e konsiderojnë BE-në palë neutrale në bisedime, gjë që tregon për perceptimin në rritje të njëanshmërisë. Nisat e fundit diplomatike, së bashku me mbështetjen e shumicës për pavarësinë e Kosovës nga shtetet anëtare, pengojnë çdo përqindje relevante të të anketuarve që do të deklarohet se BE-ja është në anën e Beogradit.

**32. Në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 është “plotësisht nuk pajtohem” dhe 5 është “plotësisht pajtohem”, vlerësoni vërtetësinë e pohimeve të mëposhtme:**

	2023	2022	2021	2020
BE-ja ka një rol kyç në zgjidhjen e problemeve të komunitetit serb në Kosovë	2.76	3.35	2.60	2.42
BE-ja luan një rol kyç në pajtimin ndëretnik në Kosovë	2.49	2.38	2.44	2.24
BE-ja investon mjaftueshëm në zonat me shumicë serbe në Kosovë	2.00	1.89	2.20	2.00


Perceptimi i rolit të Bashkimit Evropian në zgjidhjen e problemeve të komunitetit serb në Kosovë tregon për rënie të besimit në efikasitetin e BE-së. Një rritje e lehtë në krahasim me vitin paraprak është vërejtur në kontekstin e pajtimit ndëretnik, gjë që çon në përfundimin se përkundër joefikasitetit në realizimin e të drejtave të garantuara për serbët, BE-ja ende shihet si një aktor i domosdoshëm në tejkalimin e së kaluarës konfliktuoze. Një rritje e parëndësishme e besimit në BE është vërejtur edhe në kontekstin e investimeve në mjediset serbe.





REZULTATET E HULUMTIMIT  
**DISTANCA ETNIKE**

9


### 33. Sa shpesh shkoni në mjediset ku shqiptarët janë shumicë?



Duke shikuar të dhënat nga tri anketat e mëparshme, vërehet se ka luhatje të theksuar në përgjigje, përkatësisht të serbëve që shkojnë në mjediset ku shqiptarët janë shumicë. Një herë ose disa herë në javë e deri te çdo ditë sot shkojnë më shumë se 50% e të anketuarve. Ndërsa numri i atyre që shkojnë një herë ose disa herë në muaj ka rënë ndjeshëm, njëherit numri i atyre që shkojnë çdo ditë në mjediset me shumicë shqiptare është rritur. Siç pritej, të anketuarit që jetojnë në komunat në jug të Ibrit prijnë në vizitat e mjedisëve me popullatë kryesisht shqiptare, ndërsa një e pesta e të anketuarve nga veriu i Kosovës nuk shkojnë kurrë në mjediset me popullsi shqiptare, dhe më shumë se gjysma e tyre shkojnë më rrallë se njëherë ne muaj.



### 34. Eksperienca e juaj nga kontakte personale me shqiptarët kryesisht është:



Përvojat e serbëve në kontaktet personale me shqiptarët ndryshojnë, por në përgjithësi gjatë katër viteve të fundit mund të vërehen trende të caktuara. Në vitin 2023, 20.1% e të anketuarve raportojnë përvoja pozitive, që tregon për një rënie të lehtë krahasuar me vitin e kaluar (21.5%). Eksperiencat negative u dyfishuan në një përqindje totale prej 24,5%. Përvojat neutrale ende dominojnë perceptimet, pavarësisht rënies së lehtë në përqindje. E dhëna më interesante është rënia e numrit të të anketuarve që deklarojnë se nuk kanë kontakte me shqiptarët, nga 13,7% në vitin 2022 në 7% në vitin 2023, gjë që sugjeron për rritje të ndërveprimeve ndëretnike pavarësisht natyrës së këtyre marrëdhënieve.


### 35. Në një shkallë nga 1 deri në 5, vlerësoni marrëdhëniet aktuale ndëretnike në mes të komuniteteve në Kosovë, ku 1 është “jashtëzakonisht të këqija” dhe 5 është “të shkëlqyeshme”

Në një shkallë nga 1 deri në 5, vlerësoni marrëdhëniet aktuale ndëretnike në mes të komuniteteve në Kosovë	2023	2022	2021	2020
Serbë dhe shqiptarë	1.97	2.22	2.17	2.23
Serbët dhe boshnjakët	3.24	3.12	3.12	3.06
Serbët dhe goranët	3.72	3.69	3.53	3.65

Ashtu si në vitet paraprake, marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve u vlerësuan me notën më të dobët, ndërsa marrëdhëniet ndërmjet serbëve dhe boshnjakëve dhe goranëve u perceptuan si dukshëm më të mira. Kosova, si shoqëri pas konfliktit me çështje të pazgjidhura statusore dhe ndarje etnike, është terren pjellor për ruajtjen e distancës etnike ndërmjet nacionalizmave konkurrues të shqiptarëve dhe serbëve, gjë e cila reflektohet edhe në perspektivën e ndërtimit të një shoqërie të përbashkët.



## 36. Distanca etnike ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve



Shkalla e lartë e distancës etnike ndërmjet serbëve dhe shqiptarëve në Kosovë përmes analizës së trendit shprehet si vazhdimësi. Format individuale të marrëdhënieve tregojnë se përkatësia etnike ka efektin më negativ në opsionin e partnerit martesor ose lidhjeve familjare. Megjithatë, pothuajse gjysma e të anketuarve, 49,8%, do të praninin një shqiptar si mik, gjë që sugjeron se miqësia ndëretnike është një fushë ku distanca etnike në perspektivë mund të reduktohet. Vërejmë gjithashtu përqindje shumë të larta të distancimit etnik kur janë në pyetje marrëdhëniet politike. Pothuajse dy të tretat e pjesëtarëve të komunitetit serb nuk do të praninin një raport institucional ku shqiptarët nënkuptohen si bartës të pozitave më të larta.

Ky punim u botua në kuadër të projektit Rritja e Potencialit Avokues të Organizatave të Shoqërisë Civile Serbe të Kosovës, i implementuar nga OJQ AKTIV me mbështetjen financiare të Fondi Kombëtar për Demokraci (National Endowment for Democracy - NED.) Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësia e vetme e OJQ-ve AKTIV dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e NED.



